



Pranuar / Dorezuar Priljenen/Prodato Received/Delivery	08.06.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSACK	2961/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.367/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2872/2019 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.176/2019 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "28 Nëntori", SU, 1/3, Hyrja I, Nr.9, në Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.176/2019 e datës 07.03.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës "Përkthyes Shqip-Serbisht dhe Anasjelltas" në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 07.12.2018 ka parashtruar kërkesë te Sekretari i Përgjithshëm, për rritje të koeficientit nga shtatë (7), në tetë (8), ndërsa me datë 30.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kudër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi me datë 07.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1211/2019 të

regjistruar me numër A.nr.176/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Këshilli me datë 19.03.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2872/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 1211/2019 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 07.12.2018 për rritje të koeficientit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT; Shkresë e datës 25.07.2016; Shkresë për titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 05.03.2019; Ankesën e datës 30.01.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Provat shtesë të dorëzuar nga ankuesi më datë 19.03.2019; Shkresë për procedimin në sistem të pagave i datës 23.11.2017; Kërkesë për nivelizim e koeficientëve në bazë të Rregullores për Shërbyes Civil e datës 06.07.2017; Kërkesë për miratim e datës 12.06.2017; Procesverbalin e datës 22.05.2017 dhe 30.05.2017; Vendimin me Numër 201853 i datës 17.05.2017 i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Prova shtesë e datës 01.04.2019 të dorëzuar nga ankuesi; Konkursin e datës 11.03.2009; Kontratën e Punës Nr. 1/2009 e datës 01.06.2009; Kontratën e punës Ne. 2/2011 e datës 12.05.2011; Akt Emërimit e datës 02.04.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 20.01.2014; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për ankuesin datë 05.01.2015, 24.12.2015, 14.12.2016, 26.12.2017, 24.12.2018; Kërkesën e datës 19.04.2019 të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë e datës 23.04.2019; Listën e pagave janar 2018 dhe tetor 29018; Aktgjykimin A.nr.2872/2019 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Provë shtesë e datës 21.05.2021 të dorëzuar nga ankuesi; Vendimin me Nr. 2-299 i datës 09.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjejmë Kontratën e Punës të datës 01.06.2009 është konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punë si zyrtar gjuhësor – përkthyes me koeficient të pagës shtatë (7) në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ankuesi, me datë 02.04.2012 ka nënshkruar Akt Emërimin për pozitën e njëjtë të punës, po ashtu me koeficient të pagës shtatë (7).

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjie, me datë 17.05.20217 ka formuar komisionin për harmonizimin e koeficienteve të pagës për punëtorët e MASHT-it sipas Katalogut të vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës. Komisioni ka përgatitur listën e pozitave të punës të cilave është vlerësuar se duhet t'iu harmonizohet koeficienti i pagës, dhe e njëjta listë është përcjell për shqyrtim në ministrinë përgjegjëse për administratë publike. Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike, ka shqyrtuar propozimet e MASHT-it, dhe me datë 23.11.2017 përmes shkresës me numër reference DASHC/MAP-04/530, ka bërë nivelizimin e koeficienteve të pagës për disa pozita të punës në MASHT, mirëpo në listën e pozitave të aprovuar nga DASHC/MAP, nuk përfshihet pozita e punës të cilën e mban ankuesi. Po ashtu në këtë shkresë përcaktohet që: *"Për ndryshimet e bëra MASHT duhet të siguron buxhet për realizimin e tyre në sistem të pagave"*.

Me datë 21.05.2021, ankuesi ka dorëzuar si prove shtesë Vendimin Nr.2-299 të datës 09.03.2021 të U.d Sekretarit të Përgjithshëm, përmes të cilit ka njoftuar se është aprovuar ndryshimi i koeficientit të pagës nga shtatë (7), në tetë (8), dhe njëherit ka kërkuar nga Këshilli që të obligohet organi i punësimit për kompensimin e një (1) koeficienti në mënyrë retroaktive nga data 07.03.2019 deri me datë 09.03.2021. Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh se kërkesa e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës është realizuar përmes Vendimit Nr.2-299 të datës 09.03.2021, ka vlerësuar se është përmbushur objekti për të cilën është parashtruar ankesa andaj nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimit për harmonizim të koeficientit, por ka trajtuar vetëm pretendimin ankimor për kompensimin e koeficientit në mënyrë retroaktive, siç është precizuar në shkresën me numër protokolli 2536/2021 të datës 21.05.2021 të dërguar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e një (1) koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive nga data 07.03.2019, ka shqyrtuar provat e lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pretendimi ankimor si i tillë nuk qëndron sepse me provat e dorëzuara nga ankuesi dhe organi i punësimit nuk është dëshmuar se i njëjti ka nënshkruar Akt Emërimin, me koeficient të pagës tetë (8), siç parashihet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e një koeficienti në mënyrë retroaktive nga data 07.03.2019, është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.367/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe;
- Arkivit të KPMShCK-së.

